

# **Tuberculosis - Albanian**

## **Tuberkulozi**

TB-ja – sëmundja, mjekimi dhe parandalimi i saj

## **Imunizimi**

mënyra më e sigurt për mbrojtjen e shëndetit tuaj

# Tuberkulozi

TB (tuberkulozi) është një sëmundje infektive që zakonisht prek mushkëritë, edhe pse mund të prekë çdo pjesë të trupit.

Rreth 150 vjet më parë, ai shkaktoi rreth një të tetën e të gjitha vdekjeve në Mbretërinë e Bashkuar, por brenda viteve 1980, me përmirësimin e kushteve të banimit dhe të ushqimit, si dhe me mjekime efektive, ai është rralluar në Mbretërinë e Bashkuar, me 5745 raste në vitin 1987.

Megjithatë, TB-ja nuk është zhdukur plotësisht. Gjatë 20 viteve të fundit, numri i njerëzve të sëmurë me TB në Mbretërinë e Bashkuar po rritet me ngadalë. Rreth 7000 njerëz tani i ze sëmundja e TB-së çdo vit – pikërisht më shumë se një person në çdo 10.000 vetë.

Sëmundja e TB-së nuk ju ngjitet lehtësisht – duhet të jeni në kontakt të afërt dhe për një periudhë të gjatë me dikë që ka TB (zakonisht shumë ditë) – por çdo njeri duhet t'i njohë simptomat e sëmundjes, në mënyrë që të kërkohet mjekim sa më shpejt që të jetë e mundur.

**TB-ja mund të kurohet me një kurë antibiotikësh të veçantë.**

## Si përhapet TB dhe si mund të infektohem unë prej tij?

TB mund të ngjitet drejtpërdrejt vetëm nga dikush me TB infektiv në mushkëri ose fyt. Edhe pse TB shpërndahet nëpërmjet ajrit, kur njerëzit që e kanë sëmundjen kolliten ose teshtijnë, përsëri, që t'ju ngjitet sëmundja, ju duhet që të jeni në kontakt të afërt dhe për një periudhë të gjatë me dikë që është i infektuar. Prandaj, nuk ka shumë gjasa që t'ju ngjitet TB-ja në autobus apo në vaskë, për shembull.

Jo çdo njeri që ka TB të mushkërive mund të infektojë të tjerët. Nëse marrin mjekimin e duhur, shumica e njerëzve me TB infektues bëhen jo-infektues shumë shpejt – zakonisht mbas dy javëve – **nëse ata mjekohen në mënyrën e duhur.**

Edhe pse çdo njeri mund të sëmuret me TB, disa grupe njerëzish kanë më shumë rrezik se të tjerët. Këtu përfshihen ata njerëz që:

- kanë jetuar në të njëjtën shtëpi – ose që kanë qenë në kontakt të afërt dhe për një periudhë të gjatë – me dikë që ka TB infektues
- jetojnë në kushte jo të mira shëndetësore ose në kushte të mbipopulluara, duke përfshirë të pastrehët ose ata që flenë në kushte të vështira

- kanë jetuar, punuar ose qëndruar për një kohë të gjatë në një vend me një përqindje të lartë të TB-së, si p.sh. Azia jug-lindore, rajoni afrikan në jug të Saharës dhe disa vende të Evropës lindore

- mund të jenë ekspozuar ndaj TB gjatë rinisë së tyre kur sëmundja ishte më e përhapur në këtë vend

- janë fëmijët e prindërve që janë me origjinë nga vende me përqindje të lartë të TB-së

- kanë qenë në burg

- nuk janë në gjendje të luftojnë infeksionet (me imunitet të kufizuar) për shkak të sëmundjeve (p.sh. infeksioni HIV) ose për shkak të mjekimeve të ndryshme

- janë të varur ndaj drogave ose keqpërdorin alkoolin

- nuk hanë aq sa duhet për të qëndruar të shëndetshëm.

## Në ç'mënyrë do ta kuptoj që kam TB?

Simptomat më të zakonshme të TB-së përfshijnë:

- kollë të vazhdueshme që vetëm keqësohet gjatë javëve të ardhshme
- humbje peshe pa asnjë arsye të kuptueshme
- temperaturë dhe të djersitura të mëdha gjatë natës
- një ndjenjë e përgjithshme dhe e pazakonshme e lodhjes dhe e të qenit të sëmurë
- kollitje e gjakut.

**Të gjitha këto mund të jenë shenja të problemeve të tjera, por nëse i keni dhe jeni i shqetësuar, flisni me mjekun ose infermieren në kirurgjinë ose klinikën tuaj lokale, ose shkoni tek qendra NHS (Shërbimi Shëndetësor Kombëtar), ose telefononi NHS Direkt në numrin 0845 4647.**

(Për mbrojtjen e pacientëve, të gjitha telefonatat në NHS Direkt incizohen. Telefonatat kushtojnë njëllë si telefonatat lokale).

Nëse jeni në kontakt të afërt me ndonjë që është diagnostikuar me TB dhe ekziston rreziku që të jeni infektuar, do t'ju ofrohet një kontroll tek një klinikë e veçantë e TB-së.

## Nëse kam TB, a mund të shërohem?

Po, TB-ja mund të mjekohet me antibiotikë të veçantë. Mbasi të filloni mjekimin, do të filloni të ndiheni më mirë mbas dy deri në katër javë. Por mjekimi duhet të vazhdojë për të paktën gjashtë muaj. Është tepër e rëndësishme që të përfundoni kurën e plotë të antibiotikëve për të kuruar TB-në. Nëse nuk e përfundoni, TB-ja mund të rikthehet në një formë më rezistuese ndaj barnave të zakonshme dhe do të jetë tepër më e vështirë për t'u mjekuar. Gjithashtu, mund t'ia ngjisni këtë formë më të rëndë të infeksionit familjes dhe miqve tuaj.

**Nëse TB-ja nuk mjekohet në mënyrën e duhur, mund të çojë në vdekje.**

## Unë mendoja se TB-ja parandalohet me anë të vaksinës?

Ekziston një vaksinë (BCG) që është përdorur për shumë vite për të ndihmuar mbrojtjen kundër TB-së. BCG jep efekt më të mirë në parandalimin e formave më të rënda të TB-së tek fëmijët. Megjithatë, vakcina e BCG-së nuk e parandalon TB-në në të gjitha rastet dhe ju përsëri duhet t'i njihni shenjat dhe simptomat e TB-së.

## Kujt i ofrohet vakcina BCG?

Vaksina BCG u ofrohet:

- foshnjeve që kanë lindur ose jetuar në zonat ku TB ndodh 40 në 100.000 vetë apo edhe më shpesh
- foshnjeve, prindërit ose gjyshërit e të cilëve kanë lindur ose kanë ardhur nga një vend ku TB ndodh 40 në 100.000 vetë apo edhe më shpesh
- emigrantëve të rinj që nuk kanë qenë të vaksinuar më përpara nga vendet ku TB ndodh shpesh.

## Në ç'mënyrë tjetër mund të parandalohet TB-ja?

Mënyra më e rëndësishme dhe më efikase për të parandaluar përhapjen e TB-së në këtë vend është që të diagnostikohen njerëzit me sëmundjen sa më shpejt që të jetë e mundur dhe të sigurohet që ata kanë marrë kurën e plotë të mjekimit të saktë të sëmundjes. Kjo është arsyeja pse është aq e rëndësishme për të patur njohuri rreth sëmundjes.

## Do të shkoj jashtë shtetit, a kam nevojë për vaksinën BCG?

Nëse do të shkoni për të vizituar, jetuar ose punuar për më gjatë se një muaj në një vend me një përqindje të lartë të TB-së, është e rëndësishme që të jeni të mbrojtur nga TB-ja. Kërkoni këshilla në kirurgjinë ose klinikën e mjekut tuaj.

## FAKTE ME NUMRA RRETH TUBERKULOZIT

- TB-ja ka ekzistuar qysh të paktën 4000 vjet më parë – mumjet egiptiane tregojnë shenjat e sëmundjes.
- Rreth 2 miliardë njerëz (rreth një e treta e popullsisë së botës) janë të infektuar me TB – dhe kështu kanë rrezik për zhvillimin e TB-së aktive (sëmundjes së TB-së) ndonjëherë gjatë jetës së tyre.
- Organizata Botërore e Shëndetit (WHO) llogarit se në të gjithë botën rreth 9 milionë njerëz sëmuren me sëmundjen e TB-së çdo vit.
- Gjithashtu, TB-ja shkakton rreth 2 milionë vdekje çdo vit. Së bashku me malarien dhe HIV-in është një nga problemet më të rënda të sëmundjeve infektive sot në botë.
- Në rajonin afrikan në jug të Saharës, epidemia e HIV-it po i bën njerëzit më të prekshëm ndaj zhvillimit të sëmundjes së TB-së.
- Në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, TB-ja është rritur me 27% qysh në vitet 1980, nga 5745 deri në 7300 raste në vit.
- Në Londër, numri i rasteve me TB është dyfishuar qysh nga vitet 1980, me një numër prej gati 3000 rastesh në vit.
- Në Mbretërinë e Bashkuar, për shkak të mundësisë së mirë të përdorimit të shërbimeve efektive mjekësore, vdekja për shkak të TB-së është e rrallë.

## TB-ja – shqetësime të përgjithshme

Shumica e njerëzve që jetojnë në Mbretërinë e Bashkuar nuk do të ndeshin asnjëherë ndonjë rast të TB-së. Edhe pse është e rëndësishme që njerëzit të jenë të mirinformuar për simptomat e TB-së dhe të dinë se si përhapet dhe mjekohet TB-ja, është gjithashtu e rëndësishme që njerëzit ta kuptojnë rrezikun e vërtetë për vete dhe për familjet e tyre.

### **Transporti publik dhe vendet publike të mbyllura**

Përdorimi i transportit publik dhe kryerja e biznesit tuaj normal të përditshëm nuk krijon rrezik që t'ju ngjitet TB-ja.

### **TB-ja në shkolla**

Kjo ndodh shumë rrallë, por mund të krijohet ankth të madh. Fëmijët me TB pothuajse asnjëherë nuk e përhapin sëmundjen. Fëmijëve ju ngjitet sëmundja e TB-së nga të rriturit që kanë TB të mushkërive. Nëse në një shkollë zbulohet ndonjë fëmijë që ka TB, atëherë do të organizohet kontroll për të gjithë, për t'u siguruar që asnjë tjetër nuk është infektuar dhe për të identifikuar burimin e infeksionit. Burimi është zakonisht ndonjë anëtar i afërt i familjes ose dikush nga e njëjta shtëpi. Nëse ndonjë anëtar i rritur i personelit të shkollës do të zbulohet se ishte infektuar me TB, atëherë fëmijët do të kontrolloheshin sipas këshillës së organit shëndetësor publik lokal.

**Pse është ndërprerë programi i vaksinimit të fëmijëve me vaksinën BCG në shkolla, nëse TB-ja është në rritje?** Struktura e TB-së ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme qysh kur programi i vaksinimit të fëmijëve me vaksinën BCG hyri në shkolla në vitin 1953 dhe tani nuk ekziston më asnjë arsye për të vaksinuar fëmijët që kanë një rrezik shumë të vogël ndaj TB-së. Rregulli i ri u ofron vaksinën BCG atyre që kanë më shumë gjasa për të përfituar nga vaksina, sa më të rinj në moshë aq më mirë është, atëherë kur vaksina jep më shumë efekt. (Shikoni raportin me fakte të Departamentit të Shëndetit për më shumë informacion).

### **TB-ja dhe emigracioni**

Është e vërtetë që më shumë se gjysma e njerëzve që janë diagnostikuar me TB në këtë vend kanë lindur jashtë shtetit, megjithatë, vetëm roli i emigracionit nuk e shpjegon rritjen e rasteve të TB-së këto kohët e fundit. Rreth dyzet për qind e njerëzve të lindur jashtë shtetit, të cilët i ka zënë sëmundja e TB-së në këtë vend, kanë jetuar këtu për më shumë se dhjetë vjet. Veprimi më i rëndësishëm për të mbrojtur shëndetin publik është që të sigurohet se të gjitha rastet e TB-së diagnostikohen menjëherë dhe mjekohen plotësisht.

## Më shumë informacion

Kjo broshurë është në dispozicion në gjuhët e mëposhtme në faqen e internetit  
[www.immunisation.nhs.uk](http://www.immunisation.nhs.uk)

Për më shumë informacion për të mbrojtur veten, familjen dhe miqtë ndaj TB-së mund të kontaktoni:

**NHS Direct** në numrin 0845 4647\* ose bisedoni me mjekun tuaj ose me TB Alert

- Për mbrojtjen e pacientëve, të gjitha telefonatat direkt në NHS incizohen. Telefonatat kushtojnë njëlloj si telefonatat lokale.

TB Alert është një organizatë bamirëse e përkushtuar ndaj informimit rreth TB-së dhe luftimin e TB-së në të gjithë botën.

### **TB Alert**

22 Tiverton Road

London

NW10 3HL

Telefoni: 0845 456 0995

Posta elektronike: [info@tbalert.org](mailto:info@tbalert.org)

Numri i regjistrimit të organizatës

bamirëse: 1071886

Gjithashtu mund të vizitoni

[www.immunisation.nhs.uk](http://www.immunisation.nhs.uk)

[www.dh.gov.uk](http://www.dh.gov.uk)

[www.tbalert.org](http://www.tbalert.org)

[www.hpa.org.uk](http://www.hpa.org.uk)

**NHS Direct Interactive** (NHS Direkt Ndërvepruese) - një shërbim i informacionit shëndetësor që është në dispozicion në TV satelitor dixhital, duke shtypur butonin e ndërveprimit në telekomandë.

# Tuberkulozi

TB-ja – sëmundja, mjekimi dhe parandalimi i saj

Kopje të mëtejshme të kësaj broshure mund të sigurohen nga:

Departamenti i Botimeve Shëndetësore  
Telefoni: 08701 555 455  
Posta elektronike: dh@prolog.uk.com  
Tekstfon (për përdoruesit e minikomit)  
0870 0102 870 për njerëzit me vështirësi dëgjimi  
8 paradite deri në 6 mbasite E hënë – E prente

Për më shumë informacion rreth imunizimit,  
vizitoni faqen tonë të internetit  
[www.immunisation.nhs.uk](http://www.immunisation.nhs.uk)

## NHS

Informacion rreth imunizimit

© E drejta e autorit Crown 2005 266708 1p 818k Mar05 (COL) Modeluar nga "Westhill Communications"